



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim e datës 27.11.2023 të operatorit ekonomik "Schafberger Jr. Gmb-Dega Kosovë" Sh.P.K. kundër njoftimit mbi vendimin e datës 23.11.2023 për anulimin e aktivitetit të prokurimit me titull "Pastrimi i objekteve shëndetësore të KPSH-së" me nr. të prokurimit 616-23-4576-2-1-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Schafberger Jr. Gmb-Dega Kosovë" Sh.P.K. e datës 27.11.2023 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 23.11.2023 për anulimin e aktivitetit të prokurimit me titull "Pastrimi i objekteve shëndetësore të KPSH-së" me nr. të prokurimit 616-23-4576-2-1-1.
- II. **VËRTETOHET** njoftimi mbi vendimin e datës 23.11.2023 për anulimin e aktivitetit të prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHET** operatori ekonomik "Schafberger Jr. Gmb-Dega Kosovë" Sh.P.K. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "Schafberger Jr. Gmb-Dega Kosovë" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 27.11.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin e datës 23.11.2023 për anulimin e aktivitetit të prokurimit me titull "Pastrimi i objekteve shëndetësore të KPSH-së" me nr. të prokurimit 616-23-4576-2-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Lidhur me pretendimet ankimore, fillimisht duhet sqaruar se parashtruesi nuk ka arritur të prezantoj asnjë pretendim konkret kundër njoftimit mbi vendimit apo vendimeve të aktivitetit të prokurimit. Parashtruesi thjeshtë thotë se nuk pajtohet me arsyet për eliminimin e tij pasi që sipas tij këto arye janë të pabazuara. Me fjalë të tjera referati i kërkesës për rishqyrtim është shumë i përgjithësuar ku manifestohen shumë gabime logjike, ligjore dhe gjuhësore të cilat e bëjnë shumë të vështirë identifikimin e pretendimeve ankimore që parashtruesi ka synuar t'i prezantoj përmes kërkesës së tij. Pra fakti që ai nuk pajtohet me arsyet për eliminimin nuk përbën pretendim në vetvete. Pretendimi duhet të jetë i formuluar saktë dhe në mënyrë konkrete në përputhje me nenin 59 paragrafin 59.1 të RRPP ku përcaktohet se *"Kërkesat për rishqyrtim mund të ndërliken me njoftimet për kontratë, dokumentet e tenderit, ose njoftimet dhe vendimet tjera, gjatë kryerjes së aktivitetit përkatës të prokurimit"*. Sidoqoftë duhet shtuar se arsyet për eliminimin e parashtruesit janë të sakta, të konfirmuara dhe të evidentuara sikurse në raportin e vlerësimit nga komisioni objektiv dhe profesional ashtu edhe në letrën standarde për tenderuesin e eliminuar, në përputhje të plotë me LPP dhe RRPP në fuqi. Në anën tjetër, parashtruesi përmes kërkesës së tij për rishqyrtim nuk ka arritur të formuloj pretendime konkrete ankimore sikurse përcaktohet me nenin 59 paragrafin 59.1 të RRPP. Në këtë drejtim, përmes nenit 62 paragrafit 62.1 nënparagrafit b) të RRPP është përcaktuar se *"Autoriteti Kontraktues, respektivisht Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit, do ta refuzojë një kërkesë për rishqyrtim kur kërkesa nuk është paraqitur kundër një njoftimi ose vendimi siç referohet në nenin 59.1 të kësaj rregullore"*. Në këtë mënyrë është gjetur se kërkesa për rishqyrtim *prima facie* duhet të refuzohet si e pabazuar në tërësi duke u bazuar në nenin 62 par. 62.1 nënparagrafit b) lidhur me nenin 59 par. 59.1 të RRPP.

Përtej asaj që u tha më sipër, duhet theksuar se parashtruesi përmes kërkesës së tij për rishqyrtim askund nuk i ka kontestuar arsyet për anulimin e aktivitetit të prokurimit. Kujtojmë se ky aktivitet i prokurimit përmes njoftimit mbi vendimin e datës 23.11.2023 është anuluar në përputhje me nenin 62 të LPP lidhur me nenin 43 të RRPP, për shkak të arsyeve të evidentuara si në vijim:

Rezultati i aktivitetit të prokurimit:

AK përmes këtij vendimi ANULON Aktivitetin e prokurimit në mungesë të ofertave të përgjegjshëm por edhe në mungesë të informacioneve të mjaftueshme në dosje të tenderit. Në dosje të tenderit nuk është cekur numri i pikave të objekteve shëndetësore që punojnë vikendeve, po ashtu edhe OE nuk kanë bërë pyetje gjatë afatit për sqarimin e dosjes së tenderit si rrjedhojë OE ka bërë kalkulime të ndryshme në analize financiare. Kjo është një gjë që nuk mund të rikuperohet në këtë fazë të aktivitetit përfundimisht rekomandojmë anulimin e aktivitetit, poashtu nuk ka oferta të përgjegjshme për këtë aktivitet.

Përderisa parashtruesi nuk ka adresuar asnjë pretendim ankimor drejtuar arsyeve për anulimin e aktivitetit të prokurimit, kjo nënkupton që këto arsye përbëjnë fakte të pakontestueshme edhe për vet parashtruesin. Në anën tjetër parashtruesi nuk i konteston as të gjitha arsyet për eliminimin e tij si të papërgjegjshëm por vetëm disa prej këtyre arsyeve. Së këndejmi duhet cekur se arsyet e eliminimit të tij janë evidentuar përmes letrës standarde për tenderuesin e eliminuar si në vijim:

Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye:

- Ne ofertën tuaj komisioni ka vërejtur disa mangësi dhe paqartësi, komisioni e ka pare te arsyeshme te kërkoj sqarime me qellim te vlerësimit te drejte te ofertës. Komisioni i vlerësimit ka kërkuar te sqarohet mënyra e kalkulimit te vikendeve, tek kalkulimi I shpenzimeve te kompanisë tek analiza financiare shihet qe kompania kur ta bere kalkulim te ndërrimit te natës me shpenzimet e orëve shtese vetëm për 3 pika te objekteve shëndetësore, ndërsa sipas dosjes se tenderit- Aneksi 1 tek oraret e ndërrimeve shihet qe janë gjithsej 4 pika me ndërrim te natës. OE është përgjigja se punohet vetëm ne tri qendra dhe jo katër siç është cekur ne dosje.

Kjo përgjigje nuk është e pranueshme sepse OE nuk ju ka përmbajtur kërkesave te dosjes se tenderit, përkatësisht Ankesit 1 dhe orareve te cekura, ato janë kriterete te vendosura nga AK dhe nëse OE ka menduar se oraret nuk janë reale ose ka gabime,

ai ka mundur te beje kërkesë për sqarime gjate afatit për sqarime para hapjes se tenderit dhe jo tani te ndryshoj ne analize financiare

Po ashtu kalkulimi I shpenzimeve te orëve te vikendeve nuk ka përfshirë te gjitha pikat e qendrave qe punojnë edhe ne vikende por ka kalkuluar veten 3 pika për vikende përgjigja e OE ne letër standarde nuk e sqaron se pse OE nuk i ka përfshire te gjitha pikat ku duhet te jepet shërbimi ne vikende por ne vetëm 3 pika te objekteve shëndetësore.

Rrjedhimisht analiza financiare nuk është bere konform kërkesave te dosjes se tenderit dhe mos kalkulimi mire i saj e bene një oferte te papërgjegjshme.

Përfaqësuesi i autorizuar nga kompania për Trajnimin e sigurisë dhe shëndetit ne pune është Valmira Bujupaj, e cila ka qene ne te njëjtin rol si staf edhe tek OE Erik, po ashtu i njëjti staf ka qene person i autorizuar ne disa marrëveshje ose kontrata me te cilat e ka prezantuar kompaninë Erik, ndërsa për këtë aktivitet ka qenë pjesëmarrëse fizikisht për dorëzim te sigurimit për kompaninë Schafberger, duke e patur këtë fakt komisioni ngre dyshime për bashkëpunim mes te dy kompanive, dhe aplikim ne te njëjtën procedure, qe sipas ligjit te prokurimit publik nuk lejohen bashkëpunime te fshehura, OE i është bere pyetje për sqarim se *A mund te na njoftoni se çfarë roli ka stafi Valmire Bujupi, a jeni ne dijeni se e njëjta punon edhe për një kompani tjetër. Përveç sqarimeve kërkojmë edhe kontratën e punës dhe dëshminë e listës se punëtorëve te deklaruar ne ATK.*

OE ne letër standarde për përgjigje ka deklaruar se pajtohet se z. Valmira është certifikuar për siguri dhe pune por nuk e cek kohen e certifikimit, qe ne te vërtetë është koha e njëjtë ajo e marsit 2022, ditën kur edhe OE ERIK e ka bere vlerësimin e rrezikut ne pune me përfaqësuese Valmira Bujupi.

OE Scgafberger nuk e ka sjell dëshmi listën e ATK 2022 për ta pare qe a ka qene edhe z. Valmira Bujupaj staf i OE Schafberger siq ishte OE ERIK., ndërsa ka sjell vetëm Listën e vitit 2023 ku Valmira është staf aktual, përdera sa OE ERIK e ka bere te kundërtën ne përgjigje, ka sjell Listën e vitit 2022 ndërsa nuk e ka sjell Listën e vitit 2023. Dyshimet tona bazohen edhe kur vlerësojmë se OE Schafberger ne oferte ka dorëzuar vërtetimin e ATK te kompanisë ERIK, qe ne te vërtet nuk është në konzorcium me te për këtë aktivitet.

Ne e kuptojmë se është gabim teknik por pse ndodh qe një kompani te sjell ne oferte vërtetimin e një kompanie tjetër pjesëmarrëse.

Çmimi i ofruar për material shpenzues mujor është jashtëzakonisht e ulet, lista qe ka AK ka dhënë ne dosje ka gjithsej 32 produkte me sasi te ndryshme, çmimi I dhënë 75,057.48 euro për 36 muaj, qe ne baze mujore çmimi i materialit është 2084.93 euro. OE ne ofertë dhe ne përgjigje te letrës standarde nuk na ka bindur se ka llogarit te sjell te gjitha furnizimin me atë çmim. OE nuk i dhënë kalkulim te materialit ose ndonjë fature me çmim te tregut për ta bindur komisionin por është arsyetuar se faturat janë konfidenciale.

Me gjitha këto devijime nga dosja, dëshmia qe OE i ka sjell ne oferte dhe ne përgjigje te letrës standarde e bene këtë oferte te papërgjegjshme.

Duke marrë parasysh të thënat më sipër, mënyrën e formulimit të pretendimeve ankimore në kërkesën për rishqyrtim, por edhe të gjeturat e komisionit sipas raportit vlerësues është gjetur se oferta e parashtruesit është e papërgjegjshme dhe i njëjti është eliminuar si tenderues. Në këtë mënyrë është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimin e tij. Njëkohësisht nga provat materiale të administruara është gjetur se pretendimi i parashtruesit është tërësisht i pabazuar. Prandaj kërkesa për rishqyrtim është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 07.12.2023

Visar SHEHU
Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës



Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.